

20110350823

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR REZERVA TË
DETYRUESHME TË NAFTES DHE DERIVATEVE TË NAFTES

Neni 1

Në Ligjin për rezervat e detyrueshme të naftes dhe derivateve të naftes ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 84/2008), pas nenit 3 shtohen dy nene të reja 3-a dhe 3-b, si vijojne:

"Neni 3-a

(1) Nocione të vecanta, të perdorura në kete ligj e kane kete kuptim:

1. "Akreditimi" eshte proces me të cilin Instituti për Akreditim i Republikës së Maqedonise e verteton aftesine e personit juridik për kryerjen e testimi dhe kontrollit të derivateve të lengeta;

2. "Laborator i akredituar" eshte laborator ku Instituti për Akreditim i Republikës së Maqedonise e verteton aftesine e personit juridik për ta kryer testimin dhe kontrollin e karburanteve të lengeta në perputhje me standardet valide në Republikën e Maqedonise;

3. "Trup Inspektues i Akredituar për Kontroll" eshte trupi inspektues për kontroll në të cilin Instituti për Akreditimin i Republikës së Maqedonise e verteton aftesine e personit juridik për kryerjt të matjes kuantitative dhe marrjen e mostrave të karburanteve të lengeta në perputhje me standardet valide në Republikën e Maqedonise;

4. "Bioderivat" eshte derivat i lenget ose i gazte i prodhuar nga biomasa, që perdoret për nevojat e automjeteve transportuese;

5. "Marreveshje bilaterale" eshte Marreveshja e lidhur ndermjet Qeverise së Republikës së Maqedonise dhe Qeverise së cilitdo shteti anetar i BE-së me të cilen rregullohen menyra dhe kushtet e ruajtjes së rezervave të detyrueshme të Republikës së Maqedonise në objektet e magazinimit në territorin e shtetit me të cilin lidhet kontrata;

6. "Karburant tipi 1 (GM-s) për motore reaktive" eshte karburant i lenget i fosileve që perdoret për pune të motoreve reaktive;

7. "Vlere kufizuese" eshte vlere më e vogel ose më e madhe e cilesive kualitative të e karburanteve të lengeta, në perputhje me rregullen për cilesi të karburanteve të lengeta dhe kerkesave të standardeve valide të specifikimeve teknike të karburanteve në Republikën e Maqedonise;

8. "Karburant dizel" eshte karburant i lenget i fosileve me perqindje të caktuar të biodizelit (FAME) i dedikuar për motore me djegie të brendshme që punojne me procedure cizeli (ndeze kompresive) dhe perdoret për motore të mjeteve rrugore dhe hekurudhore për transportin e udhetareve dhe mallrave;

9. "Furnizues" i karburanteve të lengeta eshte personi juridik ose fizik në territorin e Republikës së Maqedonise që leshon/distribuo në treg karburante të lengeta. Mund të jete prodhues dhe/ose importues, respektivisht tregtar i karburanteve të lengeta, respektivisht prodhues sipas Ligjit për sigurine e prodhimeve;

10. "Qasja e rezerva ve të detyrueshme" paraqet qasje fizike dhe disponim i tepricave të rezervave të detyrueshme në rast të nevojave urgjente;

11. "Evaporacion" eshte avullimi i naftes dhe derivateve të naftes;

12. "Evidenca e pageses së kompensimit për rezervat e detyrueshme" eshte proces sistematik dhe i vazhdueshem me të cilin Drejtoria e detyresi i fusin të dhenat në sistemin unik për perpunimin e të dhenave;

13. "Bilanci energjetik" eshte dokument i pergatitur në baze të të dhenave për nevojat e parashikuara për lloje të vecanta të energjise apo të energjenteve nga konsumatore, prodhues dhe furnizues më të medhenj në Republikën e Maqedonise, si dhe harmonizimet dhe analizat e kryera, në Ministrine e Ekonomise;

14. "Perteritja" është proces i zëvendësimit të tepërcave ekzistuese të rezervave të detyrueshme me rezerva të derivateve të naftës me karakteristika dhe cilësi të reja, me qëllim harmonizimi me rregullat valide për kualitet karburanteve të lengeta në Republikën e Maqedonisë;

15. "Rezerva të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës (rezervat e detyrueshme) janë rezervat minimale të naftës dhe produkteve të naftës në pronësi të Republikës së Maqedonisë, të ruajtura nga Drejtoria e Rezervave të Detyrueshme të Naftës dhe Derivateve të Naftës në mënyrë që të sigurojë kushte për furnizim intervenues të tregut të naftës dhe derivateve të naftës, në rast të prishjes së sigurisë energjetike të shtetit të shkaktuara nga çrregullime në furnizimin me shkallë më të gjere;

16. "Deklarate për përputhshmeri" është dokumenti me të cilin furnizuesi garanton se cilësitë kualitative të karburanteve të lengeta të dërguara janë në përputhje me vlerat e përcaktuara me rregullen për kualitet të karburanteve të lengeta në Republikën e Maqedonisë;

17. "Kontroll i kuantitetit të derivateve të naftës" është procesi i përcaktimit fizik të sasive të derivateve të naftës, të shprehura në litra ose kilogramë, me instrumente të kalibruara;

18. "Kontroll i kualitetit të derivateve të naftës" është procesi i përcaktimit të kërkesave thelbësore të vlerave kufizuese të cilësive kualitative të karburanteve të lengeta, në përputhje me rregullen për cilësi të karburanteve të lengeta në Republikën e Maqedonisë;

19. "Vaji i lehtë për djegie EL-1" është një karburant i fosileve, në të cilin sasia e destiluar deri në 370 oC është së paku 85 përqindje volumi (duke i përfshirë edhe humbjet) dhe që përdoret si vaj për djegie për ekonomi familjare;

20. "Licence" është akti i lëshuar nga Komisioni Rregullator i Energjetikës i Republikës së Maqedonisë në bazë të së cilës personi i caktuar juridik apo fizik që kryen veprimtari energjetike dhe është i regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Maqedonisë mund të kryejë veprimtari energjetike në Republikën e Maqedonisë.

21. "Vaj për djegie - Mazut" është karburant i fosileve si mbeturinë nga distilimi atmosferik ose vakuumik i naftës. Në këtë grup të vajrave për djegie përfshihen edhe vaji i mesëm dhe i rëndë për djegie;

22. "Benzinë motorike" është karburant i dedikuar për punë të motoreve me djegie të brendshme që ndizen me kandela dhe që përdoret për motore të automjeteve të udhëtimit. Benzina motorike mund të jetë karburant i pastër fosilesh ose të përmbajë lloj dhe sasi të caktuar të biokarburantit;

23. "Naftë/Naftë e papërpunuar" është perzierje e karbohidrateve natyrore;

24. "Derivate të naftës" janë produkte të fituara nga nafta e papërpunuar duke përfshirë gjysëmproduktet, të klasifikuara në kategorite në vijim:

- destilate të lehta ose derivate të lehta të naftës (gazra të lengeta të naftës GLN-butan, propan dhe perzierje nga butani dhe propani, të gjitha llojet e benzineve motorike dhe aviokarburanteve),

- destilate të mesme ose derivate të mesme të naftës (të gjitha llojet e dizelit për automobile, vaji gazte ose vaji ekstra i lehtë për ngrohje EL-1 dhe kerozini),

- destilate të rënda ose derivate të rënda të naftës (të gjitha llojet e mazutit) e të tjera (bitumeni dhe koksi i naftës);

25. "Naftepërcues" është gyppercues me pajisje dhe stabilimente adekuate për transport të naftës së papërpunuar;

26. "Niveli i rezervave të detyrueshme" e paraqet nivelin real fizik të plotsueshmerisë së derivateve të paraqitur në ditë, të llogaritur në bazë të konsumit të brendshëm në vitin e kaluar kalendarik në pajtim me Bilancin Energjetik të Republikës së Maqedonisë;

27. "Rigjenerim i derivateve të naftës" është procesi me të cilin rezervat ekzistuese të derivateve të naftës nga rezervat e detyrueshme zëvendësohen me sasi të reja të llojit dhe cilësisë së njejtë, me qëllim që të ruhen vetitë fiziko-kimike të të njejtave;

28. " Qarkullim juridik" eshte shitja, shperndarja, magazinimi i derivateve të naftes të dedikuara për shitje dhe oferte për shitje ose cfaredo forme tjetere e bartjes, pavaresisht nese bartja eshte falas ose jo;

29. " Prodhues i derivateve të naftes" eshte bartesi i licences që kryen veprimtari të rafinimit të naftes së paperpunuar dhe prodhim të derivateve të naftes të klasifikuara në kategorite në vijim:

- destilate të lehta ose derivate të lehta të naftes (gazra të lengeta të naftes GLN-butan, propan dhe perzierje prej butani dhe propani, të gjitha llojet e benzines motorike dhe aviobenzinave,
- destilate të mesme ose derivate të mesme të naftes (të gjitha llojet e dizelit për automobile, vaji i gazit ose vaji ekstra i lehte për ngrohje EL-1, kerozina) dhe
- destilate të renda ose derivate të renda të naftes (të gjitha llojet e mazutit) e të tjera (bitumeni dhe koksi i naftes).

30. " Produktpergues" eshte gypperguesi me pajisje dhe stabilimente adekuate për transport të derivateve të naftes ose karburanteve për transport;

31. " Randman" eshte fitimi mesatar i naftes gjate perpunimit të naftes së paperpunuar;

32. " Vit referent" eshte viti kalendarik që eshte baze e të dhenave për konsumin e realizuar (Bilanci Energjetik i RM-së) dhe sherben për llogaritje të sasive të rezervave të detyrueshme që duhet të magazinohen në periudhe të caktuar kohore;

33. "Komision Rregulltar i Energjetikes i Republikes së Maqedonise" eshte trup rregullator i themeluar me ligj për energjetike, për rregullimin e ceshtjeve të ndryshme në sektorin energjetik;

34. "Testim" eshte procesi i caktimit të një apo më shume cilesive dhe karakteristikave kualitative të objektit të vleresimit të perputhshmerise (materialeve, produkteve ose proceseve) sipas procedures së caktuar;

35. "Tiketa" jane rezerva që mund të ruhen si të drejta kontraktuese për blerje të sasive të caktuar të derivateve të naftes;

36. "Tregti me shumice me nafte të paperpunuar, derivate të naftes dhe karburante për transport" eshte blerja e naftes së paperpunuar, derivateve të naftes dhe karburanteve për transport, për shitje të metejshme tregtareve, perpunuesve dhe konsumatoreve të cilet mallrat e blera i perdorin për kryerjen e veprimtarise së tyre;

37. "Tregti me pakice me derivate të naftes dhe karburante për transport" eshte shitja e derivateve të naftes dhe karburanteve për transport konsumatoreve;

38. "Shoqeri tregtare-magazinues" eshte shoqeria tregtare bartese e licences për kryerjen e veprimtarise magazinim të naftes dhe derivateve të naftes, e leshuar nga Komisioni Rregullator i Energjetikes të Republikes së Maqedonise;

39. "Importues i derivateve të naftes" eshte shoqeria tregtare bartese e licences për blerje/import të derivateve të naftes, për shitje tregtareve me pakice, konsumatoreve industriale dhe të tjere dhe/ose tregtareve të tjere me shumice;

40. "Formim i rezervave të detyrueshme të naftes dhe derivateve të naftes" eshte procesi i blerjes së derivateve të naftes me të cilin sigurohen kushte për furnizim intervenues të tregut me derivate të naftes në rast të prishjes së sigurise energjetike të shtetit, të shkaktuar nga cregullimet e furnizimit në permasa të medha;

41. "Karburante të fosileve" jane karboni, nafta e paperpunuar, derivatet e naftes dhe gazi natyror dhe

42. "Ruajtja e rezervave të detyrueshme të naftes dhe derivateve të naftes" eshte detyrim detyrues i shoqerive tregtare që kryejne perpunim të naftes së paperpunuar dhe prodhim të derivateve të naftes, dhe/ose kryejne import të naftes së paperpunuar, gjysmeprodukteve të naftes së paperpunuar dhe derivateve të naftes dhe posedojne licence për magazinim të derivateve të naftes në kapacitetet e tyre të rezervuareve/magazinave të ruajne derivate të naftes nga rezervat e detyrueshme.

(2) Në kete ligj shprehja në njejes e perfshin shumetin, nderkaq shumeti mund të jete në lidhje e njejesin, pervec kur me fjalet: "vetem" ose "pervec" nuk perjashtohet shumeti ose njejesi."

Neni 3-b

(1) Në proceduren gjate kryerjes së mbikeqyrjes së zbatimit të dispozitave të ketij ligji dhe të marreveshjeve për magazinim që e kryen Drejtoria, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedure të pergjithshme administrative, nese me kete ligj apo ligj tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

(2) Në proceduren gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese do të zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikeqyrje inspektuese, nese me kete ligj nuk është rregulluar ndryshe."

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"(1) Formimi, ruajtja dhe perteritja e rezervave të detyrueshme si dhe punet nga fusheveprimi i kompetencave të saj, Drejtoria i kryen në baze të programit afatmesem pesevjecar dhe programit vjetor me plan financiar për vitin rrjedhes.

(2) Programin afatmesem pesevjecar për formimin e rezervave të detyrueshme të naftes dhe derivateve të naftes, ndertim, mirembajtje dhe blerje të kapaciteteve të magazinimit, e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonise me propozim të Drejtorise, më së voni tre muaj para skadimit të vlefshmerise së programit paraprak.

(3) Në baze të programit afatmesem nga paragrafi (2) i ketij neni, Drejtoria perpilon program vjetor me plan financiar për çdo vit rrjedhes, që e permban edhe pjesen që ka të beje me formimin, ruajtjen, perteritjen dhe shfrytezimin e llojit, sasise dhe vleres së derivateve të naftes që blehen dhe perterihen në nivel vjetor.

(4) Programin vjetor me planin financiar nga paragrafi (3) i ketij neni, e miraton Keshilli Drejtues i Drejtorise më së voni deri më 31 dhjetor në vitin rrjedhes për vitin e ardhshem dhe e dergon në Qeverine e Republikës së Maqedonise për informim."

Neni 3

Në nenin 5 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Dinamika e formimit të rezervave të detyrueshme caktohet në baze të programit afatmesem pesevjecar dhe programit vjetor me plan financiar të Drejtorise."

Neni 4

Në nenin 6 pas fjaleve: "neni5" shtohen fjalet: "paragrafi (1)"

Neni 5

Në nenin 7 paragrafi 1, pas fjales "derivate" në rreshtin e fundit shtohen fjalet: "edhe leje për akcize", nderkaq pas fjaleve: "shoqeri tregtare" në kllapa, shtohet fjala: - magazinues.)".

(2) Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Krahas kushteve të parapara në paragrafin (1) të ketij neni, shoqerite tregtare-magazinues detyrimisht duhet t'i plotesojne edhe kushtet në vijim:

- të posedojne leje të perdorshme për magazina në të cilat ruhen rezerva të detyrueshme, sipas dispozitave valide në Republikën e Maqedonise,

- magazinat nga paragrafi (1) alineja 1 e ketij neni, të mundesojne pranim/dergim teknik të rezervave të detyrueshme me komunikacion hekurudhor dhe/ose rrugor,

- vellimi minimal i magazinave nga paragrafi (1) alineja 1 e ketij neni, (pervec për karburant për motore reaktive GM-1) të jete 1 000 m³ për derivat të naftes dhe 200m³ për GLN."

Paragrafet (3) dhe (4) ndryshohen si vijojne:

"(3) Shoqerite tregtare - magazinues nga paragrafi (1) i ketij neni detyrohen që të sigurojne së paku 20% për derivat, nga kapacitetet e pergjithshme funksionale të tyre për magazinim të derivateve të naftes nga rezervat e detyrueshme."

(4) Shoqerite tregtare-magazinues nga paragrafi (1) i ketij neni, detyrohen që rezervat e detyrueshme të derivateve të naftes që i ruajne si produkte të gatshme, për cilesi detyrimisht t'i pergjigjen standardeve më të larta valide për cilesi të karburanteve të lengeta në Republikën e Maqedonise."

Paragrafet (5), (6), (7) dhe (8) shlyhen.

Neni 6

Pas nenit 7 shtohet nen i ri 7-a, si vijon:

"Neni 7-a

(1) Drejtori i Drejtorise e cakton menyren e shperndarjes së sasive të rezervave të detyrueshme që do t'i ruajne dhe perterijne shoqerite tregtare-magazinues, në perputhje me kapacitetet e magazinave në disponim si dhe nevojen për zhvendosje territoriale të rezervave të detyrueshme.

(2) Për ruajtje dhe perteritje të rezervave të detyrueshme, Drejtori i Drejtorise lidh marrevshje me shoqerite tregtare-magazinues.

(3) Me propozim të Drejtorit të Drejtorise, Qeveria e Republikës së Maqedonise e cakton lartesine e kompensimit për ruajtje si dhe kompensimit për evaporim në pajtim me standardet e percaktuara.

(4) Rezervat e detyrueshme do të ruhen në kapacitete të magazinave (rezervuareve) të veta dhe/ose të huazuara në territorin e Republikës së Maqedonise dhe/ose në shtetet anetare të BE-së.

(5) Me perjashtim të nenit 7 paragrafi (1) i ketij ligji, pjesa e rezervave të detyrueshme mundet perkohesisht ose pergjithmone të magazinohen ruhen në shtetin anetar të BE-së, në rastin kur në territorin e Republikës së Maqedonise disponon me kapacitet magazinimi (rezervuare) për sasite e rezervave të detyrueshme nga neni 2 i ketij ligji.

(6) Për ruajtjen e rezervave të detyrueshme jashte territorit të Republikës së Maqedonise, Qeveria e Republikës së Maqedonise miraton vendim.

(7) Në baze të vendimit nga paragrafi (6) i ketij neni, të drejtat dhe detyrimet e ndersjella lidhur me magazinimin dhe ruajtjen e rezervave të detyrueshme nga paragrafi (5) i ketij neni, rregullohen me marrevshje bilaterale ndermjet Republikës së Maqedonise dhe shtetit anetar të BE-së në të cilin perkohesisht ose pergjithmone magazinohen dhe ruhen rezervat e detyrueshme."

Neni 7

Në nenin 9 paragrafi (2), ndryshohet si vijon:

"Shitja e derivateve të naftes nga paragrafi (1) i ketij neni do të kryhet nepermjet ankandit publik në pajtim me dispozitat që e rregullojne perdorimin dhe disponimin me sendet e organeve shteterore në Republikën e Maqedonise."

Neni 8

Në nenin 11, pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Drejtoria i kryen pune në vijim:

- formon, ruan, perterin, rigjeneron dhe shfrytazon rezerva të detyrueshme të naftes dhe derivateve të naftes,

- blen dhe shet naftes dhe derivateve të naftes me qellim të formimit dhe perteritjes së rezervave të detyrueshme,

- e llogarit nivelin e sasive të rezervave të detyrueshme në baze të të dhenave nga viti referues,
 - mban evidence për nivelin dhe llojin e rezervave të detyrueshme,
 - siguron sasi të rezervave të detyrueshme nga rreziqet,
 - propozon menyre për percaktimin, llogaritjen, lartesine dhe pagesen e kompensimit për rezerva të detyrueshme të naftes dhe derivate të naftes që paguhet gjate importit si dhe gjate qarkullimit të derivateve të naftes nga prodhimi vendas,
 - e mbledh kompensimin për rezerva të detyrueshme të naftes dhe derivate të naftes,
 - kujdeset për shpenzim të dedikuar të mjeteve për formim dhe magazinim të rezervave të detyrueshme,
 - propozon menyre për shfrytezimin, qasjen dhe disponimin fizik të rezervave të detyrueshme të naftes dhe derivate të naftes në rast të prishjes së sigurise energjetike të shtetit, të shkaktuar nga crregullimet e furnizimit në permasa të medha,
 - propozon masa për zbutjen e pasojave si rezultat i veshtiresive në furnizim naftes dhe derivate të naftes,
 - i percakton kushtet e magazinimit të rezervave të detyrueshme nepermjet percjelljes së disponimit të kapacitetit të magazinave,
 - nderton kapacitete të magazinave dhe i miremban ekzistueset,
 - pergatit regjister të rezervave të detyrueshme në rast të prishjes së sigurise energjetike të shtetit, të shkaktuar nga crregullimet e furnizimit në permasa të medha,
 - lidh marreveshje për magazinim të rezervave të detyrueshme dhe evidentimin e tyre,
 - i mbikeqyr dhe menaxhon me rezervave të detyrueshme,
 - e mbikeqyr zbatimin e dispozitave të ketij ligji dhe
 - pune tjera në pajtim me kete ligj.
- Paragrafet (2), (3) dhe (4) behen paragrafe (3), (4) dhe (5).

Neni 9

Në nenin 12, paragrafi (2) në alinene 2, lidheza "dhe" në fund zevendesohet me pikepresje, në alinene 3, "pika" në fund shlyhet dhe shtohet lidheza "dhe" dhe aline e re 4 si vijon:

"- në menyre aktive ta njohe gjuhen angleze".

Neni 10

Në nenin 14 pas paragrafit 1 shtohet aline e re 4 si vijon:

- "kujdeset për punen ligjore lidhur me kompetencat e percaktuara në nenin 11 të ketij ligji;"

Alineja 7 ndryshohet si vijon:

"- i propozon Keshillit Drejtues program afatshkurter pesevjecar dhe program vjetor me plan financiar të Drejtorise, që permban edhe pjese e cila ka të beje me formimin, ruajtjen, perteritjen dhe shfrytezimin e rezervave të detyrueshme;

Në alinene 8, pas fjales "vjet" shtohen fjalet: "me llogari vjetore dhe ia parashtron Keshillit Drejtues për miratim."

Alineja 9 ndryshohet si vijon: "- ia propozon Keshillit Drejtues dhe i zbaton aktet e pergjithshme për organizim dhe pune, sistematizim të vendeve të punes, rroga dhe kompensime të punonjesve në Drejtori, si dhe akte tjera të pergjithshme në kompetence të Keshillit Drejtues të parapara me kete ligj;.

Pas alinene 12 shtohen pese aline të reja 13, 14, 15, 16 dhe 17, si vijojne:

- "e propozon lartesine e kompensimit për ruajtje si dhe kompensimit për evaporim në pajtim me standardet e percaktuara."

- i percakton permbajtjen, menyren dhe afatet për themelimin, mirembajtjen dhe udheheqjen e evidences së detyresve, si dhe menyren e parashtrimit të të dhenave për mbajtjen e evidences;

- "miraton aktvendime për kthimin e kompensimit në pajtim me nenin 24-gj të ketij ligji;"

- " Keshillit Drejtues i propozon plan vjetor për furnizime publike të Drejtorise;"
- "merr vendime dhe kujdeset për zbatimin e furnizimeve publike në Drejtori në pajtim me ligjin."

Neni 11

Në nenin 17 paragrafi 1, numri "shtate" zevendesohet me numrin "pese".

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Anetaret e Keshillit Drejtues të Drejtorise i emerom Qeveria e Republikës së Maqedonise. Tre anetare të Keshillit Drejtues emerohen me propozim të ministrit kompetent për ceshtjet nga fusha e energjetikes nga radhet e personave me renome, personave të shquar profesionale në vend nga fusha e derivateve të naftes. Një anetar emerohet me propozim të ministrit kompetent për ceshtjet nga fusha e financave dhe një anetar emerohet me propozim të Komisionit Rregullator për Energjetike të Republikës së Maqedonise."

Neni 12

Neni 18 ndryshohet si vijon:

"Keshilli Drejtues i Drejtorise i kryen punet si vijojne:

- miraton statut të Drejtorise,
- miraton rregullore për punen e Drejtorise,
- miraton program vjetor me plan financiar i cili e permban edhe pjesen që ka të beje me formimin, ruajtjen, perteritjen dhe shfrytezimin e rezervave të detyrueshme,
- percakton kriteret për menyren e shperndarjes së sasive të rezervave të detyrueshme që do t'i ruajne dhe perterijne shoqerite tregtare - magazinuese,
- miraton raport vjetor për punen me llogari vjetore të Drejtorise,
- miraton raport vjetor për regjistrim të kryer të rezervave të detyrueshme të naftes dhe derivateve të naftes,
- i propozon Qeverise së Republikës së Maqedonise program pesevjecar afatmesem për formimin e rezervave të detyrueshme të derivateve të naftes, ndertimin, mirembajtjen dhe blerjen e kapaciteteve për magazinim,
- ia propozon Qeverise së Republikës së Maqedonise menyren e percaktimit, llogaritjes, lartesisë dhe pageses së kompensimit për rezervat e detyrueshme të naftes dhe derivateve të naftes, që paguhet gjate importit si dhe qarkullimit të derivateve të naftes nga prodhimi vendas,
- i parashtron propozime Qeverise së Republikës së Maqedonise lidhur me ceshtje nga fusheveprimi i punes së Drejtorise,
- i jep propozime Qeverise së Republikës së Maqedonise për marrjen e vendimeve nga fusha e rezervave të detyrueshme,
- vendos për ankesat ndaj aktvendimeve të miratuara nga Drejtori i Drejtorise në sferen e marredhenieve të punes,
- i miraton aktet e pergjithshme dhe të vecanta për punen e Drejtorise,;
- i shqyrton dhe miraton raportet për aktivitetet e Drejtorise,
- Qeverise së Republikës së Maqedonise ia propozon lartesine e kompensimit për ruajtjen dhe evaporimin e rezervave të detyrueshme,
- e percakton vleren e pikes për pagesen e rrogave dhe kompensimeve të punonjesve në Drejtori,
- i ndihmon drejtorit të Drejtorise me dhenie mendimi dhe propozimesh për implementimin e programit për pune dhe
- kryen edhe pune tjera në pajtim me kete ligj dhe statutin e Drejtorise."

Neni 13

Në nenin 20 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:
"(2) Statutin e Drejtorise e miraton Keshilli Drejtues i Drejtorise."
Paragrafi (2) behet paragraf (3).

Neni 14

Në nenin 24 paragrafet (4), (5), (6), (7), (8) dhe (9) shlyhen.

Neni 15

Pas nenit 24 shtohen shtate nene të reja 24-a, 24-b, 24-v, 24-g, 24-d dhe 24-gj, si vijojne:

"Neni 24-a

(1) Detyrimi për perllogaritjen e kompensimit për rezerva të detyrueshme nga neni 24 paragrafi (2) të ketij ligji, për prodhuesin e derivateve të naftes krijohet në momentin e leshimit në qarkullim, perkatesisht dergeses të derivateve të prodhuara të naftes nga magazinat e prodhuesit.

(2) Kompensimin nga neni 24 paragrafi (2) të ketij ligji, për prodhuesin e derivateve të naftes e llogarit vet prodhuesi dhe i njejti detyrohet që ta paguaje në llogarine perkatese të pageses në kuader të llogarise së arkës, në afat prej 15 ditësh pas kalimit të çdo muaji kalendarik në të cilin janë leshuar në qarkullim derivatet e prodhuara të naftes.

(3) Prodhuesi, detyrohet që kompensimin nga paragrafi (2) të ketij neni ta shprehe veç e veç në faturat për leshim në qarkullim të derivateve të prodhuara të naftes.

(4) Prodhuesi detyrohet që më së voni deri me të 10-in e muajit rrjedhes ta njoftoje Drejtorine për pagesen e kompensimit të rezervave të detyrueshme nga neni 24 paragrafi (2) i ketij ligji, të kryer perfundimisht me ditën e fundit të muajit paraprak.

(5) Prodhuesi detyrohet që së bashku me njoftimin nga paragrafi (4) i ketij ligji të dorezoje edhe deshmi për pagesen e kryer, perkatesisht kopje nga fletepagesa/virmani dhe kopje të fatures nga paragrafi (3) i ketij neni.

Neni 24-b

(1) Detyrimi për llogaritjen e kompensimit për rezerva të detyrueshme nga neni 24 paragrafi (2) të ketij ligji, për importuesin e derivateve të naftes krijohet në momentin e importit të derivateve të naftes, për të cilat organi doganor i Republikës së Maqedonise ka dhene deklarate doganore për import (DDI) për çdo import të kryer në veç e veç.

(2) Kompensimin nga neni 24 paragrafi (2) të ketij ligji, për importuesin e derivateve të naftes e llogarit organi doganor i cili detyrohet që ta paguaje në llogari perkatese në kuader të llogarise së arkës menjehere pas importit të kryer të derivateve të naftes.

(3) Importuesi i derivateve të naftes detyrohet që më së voni deri në të 10-in e muajit rrjedhes të njoftoje Drejtorine për pagesen e kompensimit për rezerva të detyrueshme nga neni 24 paragrafi (2) të ketij ligji, të kryer perfundimisht me ditën e fundit të muajit paraprak.

(4) Importuesi detyrohet që së bashku me njoftimin nga paragrafi (3) i ketij neni, të parashtroje edhe deshmi për pagesen e kryer, perkatesisht kopje të fletepageses/virmanit dhe specifikim të deklaratave doganore të importit.

Neni 24-v

Detyresit nga nenet 24-a dhe 24-b të ketij ligji janë detyrohet që provat për pagesen e realizuar për rezervat e detyrueshme nga neni 24 paragrafi (2) të ketij ligji, si dhe tere dokumentacionin percjelles lidhur me pagesen, t'i ruajne së paku 7 (shtate) vjet llogaritur nga periudha për të cilën kanë të bejne.

Neni 24-g

(1) Në rast se detyresit nga nenet 24-a dhe 24-b të ketij ligji e kryejne pagesen e kompensimit për rezervat e detyrueshme nga neni 24 paragrafi (2) të ketij ligji, në shume më të madhe nga ajo e percaktuar në njoftimin nga neni 24-a paragrafi (4) dhe 24-b paragrafi (3) të ketij ligji, Drejtoria shumen e paguar do ta trajtoje si akontacion për detyrimin që arrin për muajin rrjedhes.

(2) Nese detyresit nga nenet 24-a dhe 24-b të ketij ligji, nuk e paguajne kompensimin nga neni 24 paragrafi (2) të ketij ligji në shume, në menyre dhe në afatet e parapara për pagese, Drejtoria me shkrim do t'i njoftoje Inspektoratin Shteteror të Tregut dhe organet tjera kompetente në pajtim me rregullat e vecanta, me qellim zbatimin e dispozitave kundervajtese të percaktuara sipas nenit 30 të ketij ligji.

Neni 24-d

(1) Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonise detyrohet që të perpiloje raport mujor për importin e kryer të derivateve të naftes në Republikën e Maqedonise si dhe raport mujor për qarkullimin e realizuar të derivateve të naftes nga prodhimi vendas në tregun vendas dhe të njejtat t'ia paraqet Drejtorise deri në të 30-in e muajit rrjedhes, për importin e derivateve të naftes si dhe për qarkullimin e derivateve të naftes nga prodhimi vendas në tregun vendas, të kryera perfundimisht me ditën e fundit të muajit paraprak.

(2) Drejtoria dhe Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonise detyrohen që në tremujor ta bejne barazimin e të dhenave lidhur me kompensimin e paguar në llogarine pagesore në kuader të llogarise së arkës, nga detyresit.

Neni 24-gj

(1) Kompensimi nga neni 24 paragrafi (2) të ketij ligji, nuk paguhet nese sasia e derivateve të naftes që faturohet, eksportohet.

(2) Në rast të eksportit të derivateve të naftes për të cilat paraprakisht eshte paguar kompensim nga neni 24 paragrafi (2) të ketij neni, detyresi ka të drejte kthimi të kompensimit të paguar për sasi të caktuar të derivateve të naftes.

(3) Kthimi i kompensimit të paguar nga paragrafi (2) i ketij neni, behet në baze të kerkeses që detyresi e paraqet në Drejtori në afat prej 30 ditesh nga dita e kryerjes së eksportit.

(4) Menyren e kthimit të kompensimit nga paragrafi (2) i ketij neni, e percakton ministri i Financave.

(5) Kthimi i kompensimit të paguar nga paragrafi (2) i ketij neni, behet me aktvendim të drejtorit të Drejtorise, me kontroll paraprak të dokumentacionit të paraqitur dhe konstatim të permbushjes së kushteve ligjore për kthimin e kompensimit të paguar, në afat prej 30 ditesh nga dita e marrjes së aktvendimit.

(6) Në rastin nga paragrafi (1) i ketij neni, prodhuesi që e ka faturuar prodhimin detyrohet që me fature ta paraqese deklaratën doganore për eksport nga eksportuesi si prove se sasite e derivateve të naftes për të cilat nuk eshte llogaritur kompensimi jane eksportuar nga Republika e Maqedonise."

Neni 16

Në nenin 26 paragrafi (1) pas numrit "24" shtohen fjalet: "paragrafi (3)".

Neni 17

Neni 27 ndryshohet si vijon:

"(1) Mbikeqyrje mbi zbatimin e dispozitave të ketij ligji dhe të marreveshjeve për magazinim, kryen Drejtoria.

(2) Mbikeqyrjen nga paragrafi (1) i ketij e kryejne personat e autorizuar nga radhet e të punesuarve në Drejtori, në baze të autorizimit me shkrim nga drejtori i Drejtorise.

(3) Autorizimin për kryerjen e mbikeqyrjes, personave të autorizuar nga paragrafi (2) i këtij neni, e deshmojnë me dokument adekuat dhe të njëjtit detyrohet që ta tregojnë gjatë kryerjes së mbikeqyrjes, e me kërkesë të shoqërisë tregtare – magazinuese si subjekt i autorizuar (në tekstin e metutjeshëm: subjekt i kontrolluar), t'i lejojnë që ta shikojë.

(4) Personat e autorizuar nga paragrafi (2) i këtij neni kryejnë punët e mbikeqyrjes dhe marrin masa për të cilat janë të autorizuar me këto ligj dhe me ligj tjetër lidhur me:

- evidencat e obligacioneve për pagesën e kompensimit për rezervat e detyrueshme nga neni 24 paragrafi (2) i këtij ligji,

- pagesat e kompensimit për rezervat e detyrueshme nga neni 24 paragrafi (2) i këtij ligji,

- zbatimin e marrëveshjeve për magazinim,

- inspektimin në dokumentacion të shoqërisë tregtare – magazinuese lidhur me punën me rezervat e detyrueshme dhe

- kontrollin kuantitativ të sasive të rezervave të detyrueshme.

(5) Personat e autorizuar nga paragrafi (2) i këtij neni, kryejnë punët e mbikeqyrjes dhe marrin masa për të cilat janë të autorizuar me këto ligj dhe me ligjin tjetër, në bashkëpunim me organet kompetente inspektuese dhe/ose trupin inspektues kontrollues të akredituar dhe zgjedhur dhe laboratorine akredituar lidhur me:

- kontrollin kuantitativ të sasive të rezervave të detyrueshme dhe

- kontrollin kualitativ të rezervave të detyrueshme.

(6) Gjatë kryerjes së mbikeqyrjes Drejtoria mund të angazhojë edhe persona tjere profesionale fizike ose juridike nga sferat relevante për kryerjen e aktiviteteve të vecanta profesionale.

(7) Mbikeqyrja nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet edhe pa paralajmërim paraprak, në kohën kur subjekti i kontrolluar kryen aktivitetet e veta.

(8) Personat e autorizuar nga paragrafi (2) i këtij neni kryejnë mbikeqyrjen në mënyrë efektive duke mbajtur llogari për mbrojtjen e interesit publik dhe deri në shkallë sa është e mundur për mbrojtjen e interesit të subjektit të kontrolluar.

(9) Personat e autorizuar nga paragrafi (2) i këtij neni janë të autorizuar që:

- të kryejnë inspektim dhe kontroll në dokumentacionin që ka të bëjë me punën me rezervat e detyrueshme, që gjendet në lokatet afariste të subjekteve të kontrolluara,

- të kryejnë inspektim dhe kontroll në dokumentacionin që ka të bëjë me detyrimin për pagesën e kompensimit nga neni 24 paragrafi 2 i këtij ligji dhe

- kryejnë mbikeqyrje në zbatimin e dispozitave nga marrëveshjet për magazinim,

(10) Autenciteti i kopjes me origjinalin e dokumenteve, provave dhe informatave e përcakton subjekti i kontrolluar me vullnet dhe nënshkrim të vet ose i punësuarit të tij me nënshkrim.

(11) Subjekti i kontrolluar detyrohet që të bashkëpunojë dhe me kërkesë të personit të autorizuar për kryerjen e mbikeqyrjes, t'i mundësojë qasje të papënguar në kapacitetet magazinuese ku ruhen rezervat e detyrueshme si dhe hapësirat, dokumentet, sistemet elektronike ose çfarëdo qoftë mjeti tjetër në lidhje me rezervat e detyrueshme lende e mbikeqyrjes dhe ta dorëzojë dokumentacionin e plotë në lidhje me rezervat e detyrueshme të nevojshme për kryerjen e mbikeqyrjes."

Neni 18

Neni 28 ndryshohet si vijon:

„(1) Gjatë kryerjes së mbikeqyrjes, për rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës, personat e autorizuar nga neni 27 paragrafi (2) i këtij ligji përpilojnë procesverbal.

(2) Procesverbali detyrimisht duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të Drejtorisë, përfaqësuesit e organeve inspektuese kompetente, përfaqësuesit e trupit inspektues kontrollues të akredituar dhe angazhuar, menaxhuesi i depozitave dhe magazinieri i depozitave.

(3) Në baze të procesverbalit nga paragrafi (1) i këtij neni, personat e autorizuar parashtrojnë raport me shkrim me propozim – masa për menjanimin e parregullsive të konstatuara, te drejtori i Drejtorise.

(4) Drejtori i Drejtorise në suaza të kompetencave të veta ka të drejte me aktvendim t'i urdherojë shoqerite tregtare që ta harmonizojnë punën e tyre me kushtet e parapara në këto ligj, aktet nenligjore dhe marreveshjet, në afat prej më së shumti 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit me të cilin parashihet masa e kësille.

(5) Nëse në afat për harmonizimin e punës së vet të parapare në paragrafin (4) të këtij neni, shoqeria tregtare pjesërisht i menjanon mangesitë e cekura në aktvendim, e njëjta detyrohet që të dorëzojë në Drejtori, arsytim detajor me shkrim për veprimin e kësille me dokumentacion deshmues perkates në shtojcë. Pas inspektimit dhe vleresimit të arsytimit të dorëzuar, Drejtoria mund të caktojë afat plotësues të pershtatshëm për harmonizimin e punës së shoqeria tregtare.

(6) Nëse shoqeria tregtare, nuk e harmonizon punën e vet në afatet nga paragrafet (4) dhe (5) të këtij neni, Drejtoria do të marrë masa perkatese në pajtim me këto ligj.

(7) Kunder aktvendimeve të miratuara nga paragrafet (4) dhe (5) të këtij neni, shoqeria tregtare ka të drejte të ngritë kontest administrativ në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtave.

(8) Personat e autorizuar nga neni 27 paragrafi (2) të këtij ligji, që në kryerjen e mbikeqyrjes do të konstatojnë se ka elemente të vepres së kryer penale, detyrohen që për këto të dorëzojnë raport te drejtori i Drejtorise për ngritje të procedurës në organin kompetent."

Neni 19

Në nenin 29 të Ligjit, paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Kunder aktvendimit të miratuar nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqerite tregtare mund të parashtrojnë ankese në afat prej 8 (tete) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, te Komisioni për Zgjidhje të Ankesave në shkallë të dytë, i formuar nga ministri i Ekonomisë, me ç'rast kryetari i Komisionit detyrimisht do të jetë nga radhet e nepunesve shtetërore udhëheqës në shërbimin e inspeksionit që nuk do të përfshihet në kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese."

Neni 20

Neni 30 ndryshon si vijon:

"(1) Gjore në shume prej 10 000 deri në 20 000 eurosh në kundërlere me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqerise tregtare-magazinuese nëse:

- refuzon të ruajë rezerva të detyrueshme të naftës dhe derivatet e naftës (neni 7, paragrafi (1)) dhe

- rezervat e detyrueshme i shfrytëzon si mjete për sigurim të kërkesave ndaj personave të treta, peng ose çfaredo lloji të sigurimit (neni 10, paragrafi (2)).

(2) Gjore në shume prej 5 000 deri në 10 000 euro në kundërlere me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqerise tregtare- magazinuese nëse:

- nuk e paguan kompensimin në pajtim me ligjin, në menyre dhe në afate të percaktuara në nenin 24-a paragrafi (2) dhe nenin 24-b paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Gjore në shume prej 2 000 deri në 4 000 euro në kundërlere me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqerise tregtare- magazinuese nëse:

- nuk mundeson shikim në rezervat e detyrueshme dhe nuk e paraqet në shikim dhe disponim dokumentacionin lidhur me punën me rezervat e detyrueshme (neni 10, paragrafi 3) dhe

- nuk i ruan të dhenat dhe evidencën në lidhje me rezervat e detyrueshme në afatin e percaktuar në nenin 24-v të këtij ligji.

(4) Gjore në shume prej 1 000 deri në 2 000 euro në kundërlere me denare, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqerise tregtare-magazinuese nëse:

- nuk e paraqet kompensimin ndaras në fature të percaktuar në nenin 24-a paragrafi (3) të ketij ligji,

- nuk e dorezon specifikimin e deklaratave doganore importuese të percaktuara në nenin 24-b paragrafi (4) të ketij ligji dhe

- nuk i dorezon të dhenat për evidentim me kushte dhe në afate të percaktuara në nenin 26 paragrafet (3) dhe (4) të ketij ligji;

(5) Për veprimet nga paragrafet (1), (2) dhe (3) të ketij neni, do t'i shqiptohet gjobe në shume prej 500 deri në 1000 euro në kundërvlere me denare, për kundërvajtjen e kryer edhe personit përgjegjes në personin juridik.”

Neni 21

Neni 32 ndryshon si vijon:

“(1) Për kundërvajtjet e percaktuara në nenin 30 të ketij ligji, Drejtoria detyrohet që kryeresit të kundërvajtjes t'i propozojë procedure për barazim, para parashtrimit të kërkeses për procedure kundërvajtese.

(2) Personat e autorizuar për kryerjen e mbikeqyrjes përpilojnë procesverbal në të cilin shenohen elementet e rëndësishme të kundërvajtjes, koha, vendi dhe menyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e gjendur në vendin e ngjarjes.

(3) Në procesverbal caktohet menyra në të cilin do të menjahohet pasojat e demshme nga kundërvajtja, si dhe menyra e tejkalimit të pasojave nga kryerja e kundërvajtjes.

(4) Drejtoria në procedurën për barazim, kryeresit të kundërvajtjes i jep urdherpagese.

(5) Konsiderohet se kryeresi i kundërvajtjes me nënshkrim të pranimit të fletëurdhëses pajtohet që ta paguan gjoben.

(6) Kur si kryeresi i kundërvajtjes paraqitetet personi juridik, procesverbalin dhe fletëurdhësesen e nënshkruan personi zyrtar perkatesisht përgjegjes që është gjendur në vendin e ngjarjes gjatë kontrollit, ose personi tjetër zyrtar perkatesisht personi përgjegjes që ka deklaruar se ka të drejtë ta nënshkruajë procesverbalin dhe ta pranojë fletëpagesen.

(7) Deklarata nga paragrafi (6) i ketij neni regjistrohet në procesverbal.

(8) Kryeresi i kundërvajtjes detyrohet që ta paguajë gjoben në afat prej tete ditësh nga pranimi i fletëpageses në llogarinë e shënuar në fletëpagese. Kryeresi që do ta paguajë gjoben në këte afat do ta paguaj vetëm gjysmën e gjobes së shqiptuar. Këshilla për këte të drejtë është pjesë e keshilles juridike në fletëpagese.

(9) Në procedurën që do të perfundojë me dhenie të urdherpageses nuk paguhen shpenzimet e procedurës.

(10) Nëse kryeresi nuk e paguan gjoben në afat të parapare në paragrafin (8) të ketij neni, personat e autorizuar për kryerjen e mbikeqyrjes do të parashtrorjnë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente.

(11) Personat e autorizuar për kryerjen e mbikeqyrjes detyrohen që të mbajnë evidence për procedurat e ngritura për barazimin dhe për rezultatin e tyre.”

Neni 22

Procedurat e filluara për kthimin e kompensimit të paguar në rast të eksportit të kryer të derivateve të naftës, do të perfundojnë sipas dispozitave të Ligjit për rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numer 84/2008).

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".